

VENDIM
Nr. 646, datë 31.10.2018

**PËR DHËNIEN ME QIRA, ME TARIFË TË REDUKTUAR, TË SALLËS B, KATI 0
(UNDERGROUND), NË MJEDISËT E PALLATIT TË KONGRESEVE, KOMISIONIT
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për dhënie me qira, me tarifë të reduktuar, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për zhvillimin e seancave dëgjimore, të sallës B, kati 0 (*Underground*) me sipërfaqe 243 (dyqind e dyzet e tre) m², të ndodhur në ambientet e Pallatit të Kongreseve.
2. Tarifa e qirasë së sallës B, kati 0 (*Underground*), do të jetë në masën ekuivalente të shpenzimeve operative të kryera respektivisht për çdo aktivitet, gjatë gjithë periudhës së dhënies me qira.
3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama